



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

**EYE** Enhancing Youth  
Employment



**REZULTATET PILOT PËR  
MËSIMIN NË VENDIN E PUNËS  
BRENDA  
SISTEMIT TË ARSIMIT DHE  
AFTËSIMIT PROFESIONAL (AAP) NË KOSOVË**

Qershor 2019

Raport i përgatitur nga:  
Majlinda Rizvanolli Bajraktari & Fatlinda Mujko Hallaqi

## Hyrje

Ky dokument paraqet në hollësi zbatimin e arsimit dual përmes skemës së mësimin në vendin e punës (MVP) të mbështetur nga projekti i SDC-së Rritja e Punësimit të Rinjve (EYE), i cili u iniciua në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Shënimi fillon me diskutimin e kornizës ligjore dhe sfondit për MVP-në, pastaj diskuton se si EYE filloi zbatimin përmes programeve eksperimentale (pilot), duke përfshirë modalitetet për mënyrën se si u zbatua skema. Më pas jep hollësitë e gjetjeve nga zbatimi dhe përfundon duke paraqitur konkluzionet dhe rekomandimet që MASHT-i duhet t'i marr në konsideratë si institucion qendror përgjegjës, si dhe Shkollat Profesionale për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të MVP-së në të ardhmen. Për më tepër, rekomandimet e paraqitura do t'i shërbejnë projekteve tjera të donatorëve të cilët mbështesin Kosovën në përmirësimin e skemës së zbatimit të MVP-së.

## Sfondi

Në Kosovë praktika profesionale është e integruar në kurrikulën e AAP-së ekzistuese. Praktika profesionale zbatohet në kuadër të punëtorive të shkollave (disa të pajisura tashmë nga projektet e donatorëve), punëtoritë simuluese (firmat ushtrimore) dhe gjithashtu mjediset e ndërmarrjeve. Megjithatë, pavarësisht prej asaj se çfarë specifikojnë dokumentet e kurrikulës, aktualisht kjo nuk zbatohet në mënyrë sistematike.

Nga perspektiva ligjore, arsimit dual lejohet sipas Ligjit të AAP-së<sup>1</sup>, por deri më sot akti nënligjor i paraparë nuk është përpiluar për ta sqaruar atë. Megjithatë, Qeveria e Kosovës ende e konsideron të mësuarit dual si masë prioritare në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit

### Shtylla 3: LIDHJE MË E MIRË NDËRMJET ARSIMIT DHE TREGUT TË PUNËS

Zbatimi i sistemit pilot të kombinuar të AAP-së me elemente të mësimin dual (kombinimi i të nxënitorit në shkollë dhe në ndërmarrje) duke filluar me fushat prioritare të AAP-së dhe në përputhje me kurrikulën bërthamë. Koordinimi i sistemit të subvencionimit të pagesave me fushat prioritare, me qëllim që të mundësohet integrimi më i mirë i të diplomuarve të AAP-së në tregun e punës

të Kosovës 2016-2021, përmes së cilës është planifikuar të përmirësohet lidhja mes arsimit dhe tregut të punës (shikoni grafikun në vijim).

**Ndonëse arsimit dual lejohet me aktin ligjor, MASHT-i preferon termin: 'mësimi në vend të punës',** sepse e konsideron 'arsimin dual' si shumë ambicioz për Kosovën. Duke shikuar në Qendrën Evropiane për zhvillim të aftësisë profesionale -CEDEFOP (2008), termi 'arsimit dual' mund të përdoret në mënyrë alternative me termin 'mësimi në vendin e punës'. Sipas CEDEFOP:

**Mësimi në vendin e punës** është një term i gjerë me përkufizime të ndryshme. Në kuptojmë atë në kuptimin që ofron mundësi për të arritur kompetencat e lidhura me punësimin në vendin e punës që i ndihmojnë ata të lidhin përvojat shkollore me aktivitetet e punës në jetën reale. Mësimi në vend të punës shpesh realizohet në lidhje me mësimin në klasë ose i ndërlidhur me të, dhe mund të marrë formën e punës, përvojës së punës, udhëzimit në vendin e punës,

<sup>1</sup> Ligji Nr. 04/L-138 për AAP: Neni 5/3.4. Në IAAP lejohet zbatimi i formave duale të arsimit dhe aftësisë profesionale në të cilin aftësimi praktik dhe përvoja realizohet në ndërmarrje, duke kontraktuar ndërmarrjet. Kushtet dhe kriteret që drejtojnë dispozitat e tilla rregullohen me akt nënligjor

udhëzimeve për kompetencat e përgjithshme të vendit të punës dhe udhëzimit të gjerë në të gjitha aspektet e industrisë.<sup>2</sup>

Nga ana tjetër, edhe pse ekonomia në Kosovë është e ngadaltë, janë vërejtur disa shenja të interesimit nga ndërmarrjet për të nisur një bashkëpunim me shkollat profesionale në zbatim të MVP-së. Prandaj, EYE në fund të vitit 2017 vendosi të mbështesë MASHT-in për të shqyrtuar mundësitë për zbatimin e MVP-së. Modeli do të prezantojë 3 elemente të reja në sistem:

- Kompensimin e nxënësve nga ndërmarrjet (pagesa monetare, kompenzimi i transportit ose ushqimit);
- Plani i trajnimit të MVP-së i zhvilluar nga shkollat e AAP-së në bashkëpunim me instruktorët në ndërmarrje, dhe
- Trajnimi i instruktorëve në ndërmarrje (i ndërmarrë nga projekti GIZ/Youth Employment & Skills-YES);

## **Zbatimi**

---

### **Faza pilot - Grupi i parë**

MVP filloi në fillim të vitit 2018, kur EYE inicioi pilotimet e para të MVP-së për nxënësit e regjistruar në klasën e 12-të në katër shkollat profesionale. EYE lehtësoi takimet midis shkollave profesionale në Kaçanik, Ferizaj, Gjakovë dhe Vushtri dhe ndërmarrjeve vendore për të identifikuar profilet dhe përcaktuar numrin e nxënësve që ndërmarrjet do të mund t'i angazhonin, por edhe testimin e vullnetit të ndërmarrjeve. Ndërmarrjeve iu është kërkuar që të paguajnë për punën e nxënësve, ndërsa ndërmarrjet ose shkollat ishin përgjegjëse për të mbuluar sigurimin shëndetësor të nxënësve gjatë periudhës gjashtëmujore të angazhimit në kuadër të MVP-së.

Grupi i parë i MVP-së u realizua nga 15 janari 2018 deri në fund të vitit shkollor, më 15 maj 2018. Gjithsej 35 nxënës ishin pjesë e pilotimit dhe u vendosën në gjashtë ndërmarrje: Tefik Çanga, DAQA, Sela Impex, KIVO, Creative dhe Aztech. Prej 35 nxënësve fillestarë, 22 nxënës përfunduan punën e tyre si stazhier, prej të cilëve 5 u punësuan.

EYE angazhoi një konsulent vendor për të zhvilluar së bashku me ndërmarrjet planin e trajnimit të MVP-së dhe format e vlerësimit brenda ndërmarrjeve dhe gjithashtu angazhoi Institutin Federal Zvicëran për Arsim dhe Aftësim Profesional (SFIVET) për një trajnim dyditor të instruktorëve në ndërmarrje që u zhvillua në Ferizaj në muajin janar 2018.

### **Faza e zgjerimit - Grupi i dytë**

Prej shtatorit 2018, EYE vazhdoi të mbështeste të njëjtat shkolla në të njëjtat komuna, ku u zbatuan pilotimet, por këtë herë e bëri atë duke udhëzuar stafin e Qendrave të Karrierës (QK) për të identifikuar ndërmarrjet e interesuara për angazhimin e grupit të dytë të nxënësve. Kjo përvojë u dëshmuar shumë e suksesshme, veçanërisht pasi që ky ushtrim çoi në rritjen e ndërveprimit midis shkollave profesionale dhe bizneseve private. Paralelisht me këtë, EYE u zgjerua në tri komuna të reja (Prishtinë, Prizren dhe Viti) duke lehtësuar takimet me ndërmarrjet përmes Odës Ekonomike të Kosovës dhe shoqatës lokale të biznesit në Viti. Gjatë periudhës tetor-nëntor 2018, ndërmarrjet ofruan 159 vende të MVP-së për nxënës, por vetëm 121 vende u plotësuan. Në përgjithësi numri i vendeve të ofruara nga ndërmarrjet ishte më i lartë, por pasi që shkollat nuk ofronin profilet e kualifikimit të kërkuara nga ndërmarrjet,

---

<sup>2</sup> <http://www.unevoc.unesco.org/go.php?q=TVETipedia+Glossary+A-Z&filt=all&id=463> [09.10.2017]

38 kërkesa nga ndërmarrjet nuk arritën të plotësoheshin (shikoni tabelën 1 më poshtë). Kjo situatë thekson sërish problemin e mospërputhjes në nivel lokal, midis kërkesës së tregut të punës dhe profileve të ofruara nga shkollat e AAP-së.




Tabela 1: Numri i vendeve të ofruara nga ndërmarrjet dhe vendet e plotësuar nga nxënësit (grupi i dytë)

Në fillim të vitit 2019, 30 nxënës të tjerë dhe 12 ndërmarrje iu bashkuan skemës. Kështu, nga gjithsej 151 nxënës të ndërmjetësuar në 64 ndërmarrje, 142 përfunduan MVP-në (111 djem dhe 31 vajza) në 57 ndërmarrje. Prej këtyre shifrave 9 nxënës dhe 7 ndërmarrje e braktisën skemën e MVP-së. Hollësitë paraqiten në tabelat 2 - 5, më poshtë:

Shkolla AAP	# i nxënësve që filluan në nëntor 2018	# i nxënësve që filluan në fillim të vitit 2019	# i nxënësve që e braktisën MVP-në	Gjithsej # i nxënësve që përfunduan MVP-në
7 Shtatori-Prishtinë	8	0	1	7
Gjin Gazulli-Prishtinë	2	3	0	5
Shtjefen Gjecovi-Prishtinë	2	0	2	0
Zenel Hajdini-Ferizaj	19	1	0	20
Pjetër Bogdani-Ferizaj	9	10	4	15
Bahri Haxha-Vushtri	27	1	0	28
Lutfti Musiqi-Vushtri	18	0	0	18
Nexhmedin Nixha-Gjakovë	9	4	0	13
Feriz Gurri dhe Vellezerit "Caka"-Kaçanik	0	8	0	8
11 Marsi-Prizren	19	0	2	17
Jonuz Zejnullahu-Viti	8	3	0	11
<b>Gjithsej</b>	<b>121</b>	<b>30</b>	<b>9</b>	<b>142</b>

Tabela 2: Numri i nxënësve të ndërmjetësuar/angazhuar në mësimin në vendin e punës (grupi i dytë)




Tabela 3: Numri i nxënësve që morën pjesë në mësimin në vendin e punës (grupi i dytë)

Ndërmjetësimi për MVP u realizua në profilet e dhëna më poshtë:

- Automekanikë
- Shitje me pakicë dhe shumicë
- Tekstil
- Saldim
- Operator CNC
- Asistent shitjesh
- Kamerier
- Asistent kuzhinieri
- Përpunim druri
- Teknologji e ushqimit
- Dizajn metali
- Instalim elektrik
- Instalim i ngrohjes
- Informatikë
- Telekomunikim
- Dizajni i uebit

Për më tepër, meqenëse modeli i planit të trajnimit në ndërmarrje dhe formularët e vlerësimit u pritën mirë nga mësimdhënësit e shkollave gjatë pilotimit të parë, EYE në tetor 2018 ka angazhuar përsëri të njëjtin konsulent për të trajnuar stafin e Qendrave të Karrierës (QK) dhe mësimdhënësit se si të zhvillojnë këto dokumente. Anëtarët e stafit të QK-ve vazhdimisht i udhëzonin mësimdhënësit përgjegjës për praktikën profesionale se si të zhvillojnë planin e MVP-së dhe formularëte vlerësimit në bashkëpunim me instruktorët në ndërmarrje. Stafit i QK-ve arriti të përhapë këtë praktikë edhe në profilet ku MVP nuk u zbatua.

Përveç kësaj, edhe pse GIZ ka punuar në trajnimin e master trajnerëve për trajnimin e instruktorëve në ndërmarrje në Kosovë, EYE ka kontraktuar SFIVET për të ofruar prapë trajnimin dy-ditor për dy grupe në nëntor 2018 derisa GIZ të fillojë ofrimin e programit të trajnimit përmes master trajnerëve lokal. Në maj 2019, GIZ filloi të ofrojë trajnime përmes

master trajnerëve lokal dhe EYE filloi të koordinohet me projektin duke deleguar ndërmarrjet tek trajnimet e organizuara nga projekti YES-GIZ në komuna të ndryshme. Nga 64 ndërmarrje, MVP-ja u finalizua me 57 ndërmarrje. Gjatë gjithë periudhës së zbatimit, 7 ndërmarrje e kanë braktisur skemën (tabela 4 dhe 5).

Shkolla AAP	# i ndërmarrjeve që raportuan se filluan në nëntor 2018	# i ndërmarrjeve që filluan në fillim të vitit 2019	# i ndërmarrjeve që u larguan	Gjithsej # i ndërmarrjeve ku studentët përfunduan MVP-në
7 Shtatori-Prishtinë	3	0	1	2
Gjin Gazulli-Prishtinë	1	1	0	2
Shtjefen Gjecovi-Prishtinë	1	0	1	0
Zenel Hajdini-Ferizaj	13	4	4	13
Pjetër Bogdani-Ferizaj	2	1	0	3
Bahri Haxha-Vushtri	7	0	0	7
Lutfti Musiqi-Vushtri	13	0	0	13
Nexhmedin Nixha-Gjakovë	4	2	0	6
Feriz Gurri dhe Vellezerit "Caka"-Kaçanik	0	1	0	1
11 Marsi-Prizren	5	0	1	4
Jonuz Zejnullahu-Viti	3	3	0	6
<b>Gjithsej</b>	<b>52</b>	<b>12</b>	<b>7</b>	<b>57</b>

Tabela 4: Numri i ndërmarrjeve partnere për mësimin në vendin e punës




Tabela 5: Numri i ndërmarrjeve që morën pjesë në mësimin në vendin e punës (grupi i dytë)

Numri i nxënësve për shkollë në MVP ishte i ndryshëm për shkak të mënyrës së zbatimit, p.sh. fasilitimi përmes stafit të Qendrës së Karrierës ose fasilitimit nëpërmjet mësimdhënësve. Numri më i madh i ndërmjetësimeve ishte nga shkolla "Bahri Haxha" në Vushtri, e pasuar nga shkolla e mesme profesionale "Zenel Hajdini" në Ferizaj, ndërsa shkolla profesionale "Shtjefën Gjeqovi" nuk mundi të ndërmjetësonte asnjë nga nxënësit, pasi që kurrikula nuk përputhej fare me kërkesat e ndërmarrjeve (tabela 6).




Tabela 6: Numri i nxënësve në fillim/fund në MVP për shkollën e AAP-së

Nëse shikojmë profilet e kualifikimit të cilat mundën të përputhen me ofertat e ndërmjetësimit në ndërmarrje, profili automekanikë kishte numrin më të lartë të ndërmjetësimit me 21 nxënës, duke u pasuar nga shitja me pakicë dhe shumicë me 20 nxënës, dhe ndjekur nga përpunimi i ushqimit me 19 ndërmjetësime dhe tekstili me 14 ndërmjetësime (tabela 7).




Tabela 7: Numri i nxënësve që përfundoi MVP-në bazuar në profilin e kualifikimit

Nga 142 nxënës që përfunduan skemën, 22% ishin gjinisë femërore, ndërsa 78% ishin të gjinisë mashkullore. Profilet e kualifikimit ishin kryesisht të dominuar nga meshkuj (tabela 8).




Tabela 8: Përqindja e nxënësve që përfunduan skemën e MVP-së sipas gjinisë

### **Institucionalizimi i mësimit në vend të punës**

Bazuar në mësime të nxjerra nga pilotimet e zbatuara, EYE inicioi së bashku me MASHT-in përpilimin e një Udhëzimi Administrativ për të rregulluar zbatimin e MVP-së. Grupi punues përbëhej nga përfaqësues të industrisë, drejtorë të shkollave dhe mësime të tjerë, Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe përfaqësues të tjerë të projekteve të donatorëve. Pas disa takimeve të grupit dhe diskutimeve, udhëzimi administrativ u finalizua. Udhëzimi administrativ do të mbështesë Shkollat Profesionale në zbatimin e skemës së mësimit në vendin e punës.

### ***Fokus grupet me nxënës***

Në fund të majit 2019, si pjesë e aktiviteteve monitoruese, projekti EYE zhvilloi 9 diskutime në fokus grupe me nxënës nga 9 shkolla. Nga 54 nxënës (nga grupi prej 100 nxënësish në të gjitha 9 shkollat) që morën pjesë në diskutimet e fokus grupeve, 19 nxënës ishin të klasave të 12-ta dhe 35 nxënës ishin të klasave të 11-ta.

Në këto fokus grupe, 27 nga 35 nxënës të klasave të 11-ta deklaruan që u janë ofruar vendet nga të njëjtat ndërmarrje për klasën e 12-të (tabela 9).




Tabela 9: Përqindja e nxënësve të cilëve u është ofruar vazhdim i MVP-së nga ndërmarrjet gjatë klasës së 12-të

Ndërkohë, 17 prej 19 nxënësve të klasës së 12-të u është ofruar punësim në ndërmarrjet ku e kanë zbatuar MVP-në (Tabela 10).




Tabela 10: Përqindja e nxënësve të cilëve u është ofruar punësim

Informata shtesë nga diskutimi i grupit të fokusit mund t'i gjeni në Aneksin 1.

## ***Të gjeturat***

### **Të gjeturat e përgjithshme nga monitorimi i zbatimit të skemës së MVP-së janë:**

- Shkollat të cilave u mungojnë punëtoritë për ushtrimin e aftësive praktike, janë më të interesuarat për zbatimin e skemës MVP; shkollat të cilat kanë punëtori me pajisje

themelore janë të interesuara për MVP pasi që ato konsiderojnë se praktika reale në vendin e punës nuk mund të zëvendësohet me praktikën në punëtoritë e shkollave; një shkollë e cila ka punëtori shumë të pajisur dhe tashmë ka vendosur bashkëpunim me ndërmarrjet private nuk ishte e interesuar për të futur skemën e MVP-së;

- Meqenëse ndërmarrjet në Kosovë janë mjaft të vogla, rrallë është e mundur që MVP-ja të mbulojë kërkesat e kurrikulës vetëm në një biznes; shkollat duhet të identifikojnë më shumë biznese dhe të qarkullojnë nxënësit përmes rrotacionit në mënyrë që nxënësit të mund t'i ushtrojnë të gjitha modulet nga kurrikula përkatëse. Kjo situatë ka krijuar probleme për shkollat, pasi që ata duhet të gjejnë mënyrën për t'i mbuluar modulet e tjera të papërfshira;
- Ndërmarrjet që kontribuojnë financiarisht kanë interes dhe angazhim më të lartë me nxënësit;
- Plani i MVP-së është pranuar shumë mirë nga stafi i shkollës dhe nga ndërmarrjet. Pyetja e madhe është se kush do ta realizojë atë pas mbarimit të projektit EYE? Nëse plani i MVP-së ishte shumë mirë i pranuar, MASHT duhet të gjejë zgjidhje se si ta inkorporojë atë në sistem. Projekti EYE ka trajnuar stafin e QK-ve në mënyrë që ata vazhdimisht të udhëzojnë kolegët e tyre, por edhe kolegët e rinj në zhvillimin dhe përdorimin e planit të aftësisë të MVP-së;
- Shkollat që kanë Qendrat e Karrierës brenda mjediseve të shkollës kanë zbatuar skemën më me sukses se ato që nuk kanë; pika kryesore për promovimin e MVP-së dhe vendosja e bashkëpunimit me ndërmarrje ishin stafi i QK-ve; për më tepër, stafi i QK-ve ka ofruar vazhdimisht udhëzime për të gjithë mësuesit përgjegjës për praktikën profesionale se si të zhvillojnë planet e MVP-së dhe formularët e vlerësimit së bashku me instruktorët brenda ndërmarrjes; stafi i QK-ve ka arritur të përhapë këtë praktikë edhe në profilet ku MVP-ja nuk është zbatuar.
- Për shkak të mungesës së Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga MASHT, stafi i QK-ve duhej të kryente edhe detyrat e disa mësimitdhënësve që nuk merrnin përgjegjësinë për monitorimin e nxënësve; stafi i QK-ve ishte i irrituar kur bashkëpunimi me një ndërmarrje u ndal për shkak të neglizhencës së mësimitdhënësve;
- Zbatimi i MVP-së ka ndryshuar nga komuna në komunë. Gatishmëria varej nga nevoja për punëtorë të kualifikuar nga sektori; p.sh. sektori i 'hotelerisë' në Prishtinë ose sektori i 'teknologjisë së ushqimit' dhe 'përpunimit të drurit' në Ferizaj ishin më të përkushtuar në zbatimin e skemës;
- Skema e MVP-së në disa profile të 2 shkollave nuk është zbatuar në përputhje me kohëzgjatjen e caktuar (klasa e 11-të 1 ditë/8 orë, klasa e 12-të, 2 ditë/16 orë). Nxënësit po kalonin më pak kohë në ndërmarrje (sipas orarit të caktuar në kurrikulë). Shkollat duhet të informohen se ndërmarrjet nuk do të kenë interes të bashkëpunojnë me shkollat, nëse nxënësit kalojnë shumë pakë kohë në mjediset e ndërmarrjes; Nuk ka kthim të investimit për ndërmarrjet';

#### **Të gjeturat nga diskutimet e fokus grupeve me nxënësit janë:**

- Nxënësit nuk u përzgjedhën nga ndërmarrjet në shumicën e shkollave të AAP-së, por në disa prej tyre u intervistuan. Përfundim është Kaçaniku, ku KIVO ka intervistuar nxënësit dhe më pas ka përzgjedhur nxënësit më të përshtatshëm;
- Shumica e prindërve ishin të informuar nga shkolla për mundësinë e MVP-së dhe pothuajse të gjithë e vlerësonin pozitivisht mundësinë;
- Gjysma e nxënësve u sollën nga mësimitdhënësit përgjegjës të shkollave tek ndërmarrjet;

- Edhe pse jo të gjithë instruktorët e ndërmarrjeve iu nënshtruan trajnimit të instruktorëve në ndërmarrje, shumica e nxënësve ishin të kënaqur me udhëzimet dhe mbështetjen që u ofrohej atyre;
- Shumica e nxënësve u informuan nga mësimdhënësit e shkollave dhe instruktorët në ndërmarrje rreth procesit të vlerësimit dhe ata konsiderojnë se kjo është mënyra se si duhet të bëhet gjithnjë, pasi që ata njohin më mirë kompetencat e fituara të nxënësve;
- Nxënësit vlerësuan shumë mundësinë e praktikës në ambientin e vërtetë të punës;
- Disa nga nxënësit nuk u monitoruan nga mësimdhënësit e shkollës; menaxhmenti i shkollës duhet të monitorojë më nga afër mësimdhënësit;
- Disa nga nxënësit që iu nënshtruan trajnimeve fillestare në punëtoritë e shkollave konsiderojnë se praktika bazë në shkollë i ndihmoi ata të përshtateshin më shpejt në ndërmarrje;
- Në disa raste, vetë nxënësit i identifikuan ndërmarrjet dhe i kërkuan stafit të QK-ve/mësimdhënësve t'i nënshkruajnë marrëveshjet;
- Ka raste kur ndërmarrjet kanë ftuar nxënësit të punojnë më shumë me kompensim, por ka edhe ndërmarrje që kanë përdorur nxënësit për më shumë ditë pa pagesë shtesë;
- Bazuar në diskutimin e grupit të fokusit, rreth 80% e nxënësve të klasës së 11-të do të vazhdojnë skemën e MVP-së në klasën e 12-të në të njëjtat ndërmarrje, por gjithashtu afërsisht 87% të nxënësve të klasës së 12-të ndërmarrjet u kanë ofruar vende pune;
- Më shumë se 70% e nxënësve zgjedhën shkollën dhe kualifikimin me vullnetin e tyre;
- Rreth 30% e nxënësve janë të gatshëm të vazhdojnë arsimin e lartë; prej tyre shumica ishin të interesuar të studionin dhe të punonin paralelisht;

## ***Përfundimi dhe rekomandimet***

---

Bazuar në të gjeturat e identifikuar gjatë monitorimit të zbatimit të MVP-së, intervistat me stafin e shkollave dhe disa nga ndërmarrjet duke përfshirë edhe diskutimet e fokus grupeve me nxënësit<sup>3</sup>, rekomandimet kryesore nga projekti EYE janë:

- Skema e MVP-së duhet të vazhdojë të ofrohet, por ajo duhet të jetë e kufizuar në sektorët që kanë nevojë të theksuar për punëtorë të kualifikuar, por gjithashtu edhe gatishmërinë për të bashkëpunuar; skema si e tillë do të krijojë ndërveprimin midis shkollave të AAP-së dhe bizneseve lokale; rastet e suksesshme duhet të promovohen në një komunitet më të gjerë afarist, në mënyrë që të nxitet interesi i ndërmarrjeve të reja nga sektorët potencial, ashtu që shkolla të sigurojë ndërmjetësimin e nxënësve për të gjithë klasën;
- Udhëzimi Administrativ për MVP duhet të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që rolet dhe përgjegjësitë të përcaktohen dhe kuptohen qartë nga të gjitha palët e involvuara;
- Zhvillimi i doracakut për zbatimin e MVP-së me formularët e nevojshëm, bazuar në Udhëzimin Administrativ për të lehtësuar zbatimin e MVP-së për të gjitha palët;
- MVP duhet të zbatohet në shkollat ku QK-të janë prezent ose të paktën aty ku shkollat kanë një zyrtar përgjegjës për ndërlidhje me ndërmarrjet;
- OEK përmes zyrave të saja rajonale duhet të mbështesë shkollat e AAP-së për të zgjeruar bashkëpunimin me ndërmarrjet lokale;

---

<sup>3</sup> Shtojca 1

- Skema e zbatimit të MVP-së duhet të ndihmohet nga akterët lokal, meqë interesimi më e madh qëndron tek ata për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë lokale;
- Zgjedhja e ndërmarrjeve duhet të bëhet përmes kritereve minimale të përcaktuara, si: kompensimi, disponueshmëria e instruktorit në ndërmarrje, mjedisit të përshtatshëm të punës, etj. Kriteret duhet të përcaktohen nga OEK dhe MASHT në bashkëpunim me ndërmarrjet;
- Më shumë seanca informuese duhet të realizohen/mbahen me mësimdhënësit për të shpjeguar rolin dhe përgjegjësinë e tyre në zbatimin e skemës së MVP-së;
- Plani i trajnimit të MVP-së duhet të njihet si model dhe MASHT duhet të shqyrtojë mundësitë se si të integrohet modeli në sistemin e arsimit të AAP-së;
- Udhëzimi administrativ për provimin përfundimtar duhet të rishikohet bazuar në praktikën e MVP-së;
- Trajnimet për instruktorët në ndërmarrje duhet të ofrohen vazhdimisht nga projekti YES i GIZ-it; projekti YES i GIZ-it së bashku me akterët tjerë duhet të identifikojë institucionin i cili do të ketë për detyrë të ofrojë trajnime për instruktorët në ndërmarrje; sipas shkollave dhe nxënësve, ndërmarrjet duhet të rrisin kapacitetet e mentorimit brenda bizneseve të tyre;
- Shkollat e AAP-së duhet të fasilitojnë komunikimin më intensiv me ndërmarrjet lokale;
- MASHT-i duhet të shqyrtoj mundësinë e nxitjes së nxënësve përmes menaxhmentit të shkollës, duke i liruar ata nga provimi përfundimtar i brendshëm, nëse e përfundojnë me sukses skemën e MVP-së;
- Nëse ndërmarrjet nuk janë të interesuara të zgjedhin vetë nxënësit, shkollat e AAP-së duhet të zgjedhin nxënësit në bazë të kritereve të përcaktuara nga shkolla e AAP-së. Një nga kriteret kryesore duhet të jetë vullneti për punë praktike dhe sjellja e nxënësve;
- Shkollat e AAP-së duhet të informohen se si mund të përdorin fondet e dedikuara nga qeveria qendrore për sigurimin e aksidenteve, kompensimin e transportit dhe përmirësimin e pajisjeve për punëtoritë; duhet të fasilitohen më shumë takime mes MASHT-it, Drejtorateve Komunale të Arsimit (DKA) dhe shkollave të AAP-së në nivel lokal, me qëllim të diskutimit të proceseve të përdorimit të fondeve të dedikuara;

Shtojca 1: Të gjeturat nga diskutimet e grupeve të fokusit me nxënësit e angazhuar përmes skemës së MVP-së

Nr.	Shkolla e AAP-së Komuna/ Ndërmarrjet/ Profilet	# i nxënësve në fillim	# i nxënësve në fund	# i ndërmarrjeve në fillim	# i ndërmarrjeve në fund	Sfidat	Mësimet e nxjerra
1	<p>“7 shtatori” Prishtinë Nxënësit e klasës së 12-të</p> <p>3 në Aztech 4 në Al Petrol</p> <p>Asistent Kamerier Kuzhinier Shitje me shumicë dhe pakicë</p>	9	7	3	2	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedhja e nxënësve është bërë nga drejtori i shkollës në koordinim me mësimdhënësit;</li> <li>• Nxënësit hasin probleme në sigurimin e transportit, sepse shumica e bizneseve janë të vendosura jashtë Prishtinës;</li> <li>• Mungesa e sigurimit të aksidenteve,</li> <li>• Ndërmarrjet janë të interesuara të punësojnë nxënësit me orë të gjata pune, gjë që i pengon nxënësit të jenë të rregullt në shkollë;</li> <li>• Shumica e nxënësve janë të punësuar me kohë të plotë/prandaj interesimi dhe mundësitë për MVP janë të ulëta;</li> <li>• Cilësia e ulët e nxënësve, mungesa e aftësive të gjuhës angleze;</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Skema e MVP-së përmirëson komunikimin me ndërmarrjet; konsiderohet më e përshtatshme për shkak të qasjes së saj të strukturuar, siç janë: zhvillimi i planit të MVP-së, vlerësimi i nxënësve nga ndërmarrjet, monitorimi i rregullt dhe komunikimi ndërmjet të dy palëve;</li> <li>• Menaxhmenti i shkollës ka nxitur nxënësit duke i liruar ata nga provimi përfundimtar i brendshëm, nëse e përfundojnë me sukses skemën e MVP-së;</li> <li>• Për shkak të mungesës së punëtorive, shkolla/stafi është shumë i motivuar për skemën e MVP-së;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 7 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit u angazhuan 2 ditë (8 orë) në javë;</li> </ul>

						<ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e infrastrukturës/punëtorive për trajnim bazë;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 7 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vështirësitë me transportin për shkak të vendndodhjes së bizneseve;</li> <li>Për shkak të specifikave të profesionit (kuzhinier), orët e punës nuk ishin të përshtatshme për nxënësit;</li> <li>Nxënësi i katërt siguroi angazhimin në Alpetrol, si rezultat i ndihmës së shokëve të tij;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjithë nxënësit janë kompensuar me 50 euro në muaj (Alpetrol gjithashtu ofroi ushqim);</li> <li>Nxënësit vlerësojnë mentorimin dhe vlerësimin nga ndërmarrjet dhe mundësinë për të bërë punë praktike me orar më të gjatë krahasuar me skemën e mëparshme.</li> <li>Të dyja ndërmarrjet kishin instruktorë në ndërmarrje;</li> <li>Të gjithë nxënësve u është ofruar punësim (2 nxënës nuk janë të interesuar të punësohen për shkak të ndërrimit të natës)</li> <li>4 nga 6 nxënësit e kanë zgjedhur vetë shkollën;</li> </ul>
2	<p><b>“Gjin Gazulli”</b> <b>Prishtinë</b> <b>Nxënësit e klasës së 12-të</b></p> <p><b>2 në Bonevet</b> <b>3 në Decon</b></p> <p><b>Informatikë</b> <b>Instalim elektrik</b></p>	2	5	1	2	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vonesa me ndërmjetësim në Decon për shkak të kushteve atmosferike;</li> <li>Skema e subvencionuar e praktikës nga BE përmes ICK (50 nxënës) ndikon në zbatimin e skemës së MVP-së;</li> <li>Kurrikula nga profili i Informatikës nuk korrespondon me nevojat e biznesit;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 5 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit u zgjodhën nga mësimdhënësi përgjegjës për praktikën profesionale dhe vetëm Bonevet i intervistoi ata;</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkolla vlerëson vlerësimin e nxënësve të kryer nga ndërmarrjet;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 5 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit u angazhuan 2 ditë (8 orë) në javë;</li> <li>Nxënësit do të donin ta kishin këtë mundësi nga klasa e 11-të;</li> <li>Nxënësit kërkuan të kenë më shumë informata në fazën fillestare, p.sh. broshurat;</li> <li>BoneVet ka ofruar kurse shtesë falas (Python);</li> <li>Të gjithë nxënësit u kompensuan 50 euro në muaj, transport dhe ushqim</li> </ul>

						<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ka punëtori në shkollë, LuxDev do të investojë në shkollë që nga vera;</li> <li>Nxënësit i janë ekspozuar praktikës në biznese për herë të parë;</li> <li>Nuk pati monitorim nga mësimdhënësit e shkollave;</li> </ul>	<p>(Decon ofroi ushqimin dhe transportin e vet gjithashtu);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të dyja ndërmarrjet kishin instruktorë në ndërmarrje;</li> <li>Decon ofroi punësim gjatë verës;</li> <li>Të 5 nxënësit e kanë zgjedhur vetë shkollën;</li> <li>Lëndët e përgjithshme të zëvendësohen me pjesën praktike;</li> </ul>
3	<p>“Shtjefën Gjeqovi” Prishtinë Nxënësit e klasës së 12-të</p> <p>0 në Rail trans 0 në Decon</p> <p>Kontrollues i trenit</p>	2	0	1	0	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kurrikula nuk iu përgjigj kërkesave të "Rail Trans", megjithëse "Rail trans" u siguroi atyre të dhëna për rishikimin e kurrikulave.</li> <li>Përveç kësaj, shkolla nuk ishte e interesuar të dërgonte nxënësit, sepse angazhimi i nxënësve kërkohej vetëm kur dërgesat do të vinin.</li> <li>Nxënësit nuk filluan në "DECON", sepse vendndodhja ishte shumë larg;</li> </ul> <p><b>Pa grup fokusi me nxënësit</b></p>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesë vullneti nga shkolla për të zbatuar MVP-në, për shkak të punëtorive të pajisura në shkollë.</li> <li>Shkolla fasilton praktikën në biznese me nismë të tyre, zakonisht për klasat e 12-ta; Nxënësit më të mirë ose ndërmjetësohen në ndërmarrje ose punësohen prej tyre, sidomos në profilet e tekstilit dhe auto-mekanikës;</li> </ul> <p><b>Pa grup fokusi me nxënësit</b></p>
4	<p>“Bahri Haxha” Vushtrri Nxënësit e klasës së 11-të</p> <p>9 Edona market 11 Edona market 1 1 Te binqet 1 Te Albani</p>	27	28	7	7	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mentaliteti i biznesit është shumë i ndryshëm nga qytetet e tjera; shumica e tyre hezitojnë të kompensojnë nxënësit në çfarëdo forme;</li> <li>Të gjithë nxënësit (me përjashtim të profilit të auto-mekanikës) u ndërmjetësuan në ndërmarrje</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Edhe pse shumica e nxënësve u ndërmjetësuan në biznese pa asnjë kompensim, shkolla ngurron të ndërpresë bashkëpunimin pasi që ata konsiderojnë se nxënësit përfitojnë së paku disa aftësi.</li> </ul>

	<b>3 Drini i bardhë</b> <b>1 Shega</b> <b>2 Be -Commerc</b>  <b>Shitje me shumicë dhe pakicë</b> <b>Përpunim ushqimi</b>					bazuar në orët e praktikës të shënuara në kurrikulë  <b>Fokus grupet me nxënësit</b> <b>12 nxënës nga "Bahri Haxha"</b> <b>5 nxënës nga "Lutfi Musiqi"</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit u zgjodhën nga mësimdhënësi përgjegjës për praktikën profesionale në bashkëpunim me stafin e OK-së;</li> <li>Një nxënës nga "Bahri Haxha" të klasës së 11-të i është ofruar punë;</li> <li>"Ajna cake" u kërkoi nxënësve të punonin gjatë verës, por pa kompensim;</li> <li>Një nxënës "Interex" i ofroi një punë, por ata nuk ishin fleksibil për të rregulluar orarin e punës për shkak të vështirësive në transport;</li> <li>Monitorimi nga mësimdhënësit është bërë rrallë;</li> <li>Vlerësimi i nxënësve u krye nga ndërmarrjet;</li> <li>Disa nxënësve u mungoi vlerësimi nga ndërmarrja;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>MVP-ja duhet të zbatohet sipas procedurave të Udhëzimit Administrativ;</li> <li>Më shumë seanca informuese dhe prezantime të Udhëzimit Administrativ për MVP-të duhet të mbahen/realizohen me mësimdhënësit për të shpjeguar rolin dhe përgjegjësinë e tyre në zbatimin e skemës së MVP-së;</li> </ul> <b>Fokus grupet me nxënësit:</b> <b>12 nxënës nga "Bahri Haxha"</b> <b>5 nxënës nga "Lutfi Musiqi"</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit e klasës së 11-të të shkollës "Bahri Haxha" janë angazhuar 1 ditë (4 orë) në javë, nxënësit e klasës 12-të janë angazhuar 2 ditë (më pak se 8 orë); 9 u kompensuan me ushqim dhe 3 nuk u kompensuan fare;</li> <li>Nxënësit e klasave të 12-ta të shkollës "Lutfi Musiqi" u angazhuan 3 ditë (rreth 8 orë) në javë; 4 nxënës u kompensuan me ushqim dhe 1 nuk u kompensua fare;</li> <li>Nxënësit nga "Lutfi Musiqi" u ankuan se ndërmarrjet që u ofruan nga shkolla, nuk i angazhuan ata në punë reale, prandaj ata u detyruan që t'i identifikojnë vetë ndërmarrjet e reja;</li> <li>Një nxënës nga "Lutfi Musiqi" i është ofruar punë;</li> <li>Disa nga ndërmarrjet kishin instruktorë në ndërmarrje;</li> </ul>
6	<b>"Lutfi Musiqi"</b> <b>Vushtrri</b> <b>Nxënësit e klasës së 11-të</b>  <b>Automekanik</b>  <b>1 "Te Xhevati"</b> <b>1 "Ardi"</b> <b>3 "Te Aliu"</b> <b>2 "Diari"</b> <b>1 "Vllezrit Bunjaku"</b> <b>3 "Dini"</b> <b>1 "Behari"</b> <b>1 "Maxhuni"</b> <b>1 "Univerzal"</b> <b>1 "Ridvani"</b> <b>1 "Beni"</b>	18	18	13	13		

							<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumica e nxënësve e vlerësuan mundësinë e punës praktike në ndërmarrje pasi që ata mësuan shumë;</li> <li>• Nxënësit kërkojnë forma të ndryshme të kompensimit nga ndërmarrjet për të qenë më të stimuluar;</li> </ul>
7	<p><b>“Zenel Hajdini”</b>  <b>Ferizaj</b>  <b>Nxënësit e</b>  <b>klasës së 11-të</b></p> <p><b>4 Rrezja</b>  <b>1 Oferta</b>  <b>2 Mahalla</b>  <b>1 Plus Market</b>  <b>1 Drini</b>  <b>1 Neti</b>  <b>1 Multimob</b>  <b>2 Arditi</b>  <b>2 Folea</b>  <b>1 Vlera</b>  <b>1 Elida</b>  <b>2 Edona 5</b>  <b>1 N.T.B. Modë</b></p> <p><b>Përpunim druri</b>  <b>Përpunim</b>  <b>ushqimi</b>  <b>Tekstil</b></p>	19	20	13	13	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtori i shkollës konsideron se MVP-ja po krijon vështirësi në orarin e mësimdhënësve që monitorojnë zbatimin e praktikës profesionale;</li> <li>• Për shkak të ndërmjetësimi të limituar të nxënësve në ndërmarrje, nxënësit e mbetur nuk shfaqen në shkollë dhe kjo po krijon dallim në mes të aftësive të nxënësve; nga ana tjetër, drejtori është i shqetësuar pasi në fund të gjithë nxënësit marrin diploma;</li> <li>• Nuk ka buxhet të siguruar nga MZHE për transportin e mësimdhënësve dhe stafit të OK-së për të monitoruar nxënësit;</li> <li>• Mësimdhënësit përgjegjës për të monitoruar nxënësit nuk marrin përgjegjësinë për ta bërë këtë, por e lënë detyrimin tek stafi i OK-së;</li> <li>• Për shkak të neglizhencës së mësimdhënësit përgjegjës, nxënësi</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fasilitimi i diskutimeve ndërmjet MZHE, DAAP/MASHT dhe shkollës AAP për sigurimin e buxhetit për transportin e mësimdhënësve;</li> <li>• Rritja e kapaciteteve të instruktorëve në ndërmarrje tek ndërmarrjet për monitorimin dhe vlerësimin e nxënësve;</li> <li>• Më shumë seanca informuese dhe prezantime të Udhëzimit Administrativ për MVP-të duhet të mbahen / realizohen me mësimdhënësit për të shpjeguar rolin dhe përgjegjësinë e tyre në zbatimin e skemës së MVP-së;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 12 nxënës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit u angazhuan 1 ditë (8 orë) në javë; edhe pse atyre u është ofruar të punojnë të shtunën për pagesë shtesë, ata kanë refuzuar;</li> <li>• Të gjithë nxënësit u ftuan të vazhdonin me MVP në klasën e 12-të; një nxënësit i është ofruar punë gjatë verës, por ai nuk pranoi të punonte</li> </ul>

						<p>e ka ndërprerë MVP-në në "Tefik Çanga"</p> <p><b>Fokus grupet me 12 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit vlerësojnë punën praktike në biznese, sepse ajo ka më shumë larmi ushtrimesh dhe është më sfiduese;</li> <li>Nxënësit i janë ekspozuar për herë të parë punës praktike; më parë ata realizonin vetëm vizita nëpër biznese; ata do të dëshironin të fitonin disa aftësi në punëtoritë e shkollave;</li> <li>Monitorimi i nxënësve u realizua jo shumë shpesh nga mësimdhënësi përgjegjës për praktikën;</li> <li>Vlerësimi i nxënësve do të bëhet në fund të praktikës;</li> </ul>	<p>për shkak të pushimeve verore; ata do të vazhdojnë me skemën MVP nëse gjatë klasës së 12-të do të kompensohen më shumë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Një nga 12 nxënësit e intervistuar nuk u pagua fare. Të tjetër u paguan 20-25 euro në muaj;</li> <li>Të gjithë nxënësit u monitoruan nga instruktorët në ndërmarrje dhe u vizituan shpesh nga mësimdhënësit e shkollës dhe stafi i OK-së;</li> <li>Një nxënës krijoi probleme në ndërmarrje dhe shkolla vendosi ta tërheqë atë në mënyrë që të mos shkatërronte bashkëpunimin me ndërmarrjen;</li> <li>Vetëm një nxënës nga të gjithë nxënësit është regjistruar në shkollë kundër vullnetit të tij; vetëm disa duan të vazhdojnë arsimin e mëtejshëm;</li> </ul>
8	<p><b>"Pjetër Bogdani"</b>  <b>Ferizaj</b>  <b>Nxënësit e klasës së 11-të</b></p> <p><b>3 Mikron</b>  <b>2 Vegëltorja</b>  <b>"plus"</b>  <b>0 IMK</b></p>	10	5	2	2	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkolla u ballafaqua me probleme që nga fillimi me fabrikën IMK. Fabrika vazhdimisht premtonte të ndërmjetësonte nxënësit, por ata kurrë nuk iu përgjigjën shkollës.</li> <li>Fasilitimi u realizua nga zëvendës drejtori, ndërkohë që përzgjedhja e nxënësve ishte bërë</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kurrikula nuk i përgjigjet nevojave të ndërmarrjes për shkak të teknologjisë së përparuar;</li> <li>3 nxënës në Mikron do të vazhdojnë skemën MVP gjatë klasës së 12-të;</li> <li>Zëvendës drejtori mori pjesë në trajnimin e instruktorëve në ndërmarrje të organizuar nga GIZ. E</li> </ul>

	<b>Operatorët CNC Mekanika e makinerisë</b>					<p>nga mësimdhënësi përgjegjës për praktikën profesionale;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit nuk u intervistuan nga ndërmarrja para përzgjedhjes;</li> <li>5 nxënës u ndërmjetësuan në Vegëltorja "Plus", 3 prej tyre u tërhoqën sepse nuk ishin paguar. Njëri prej tyre iu bashkua Mikron-it;</li> <li>Më shumë nxënës ishin të gatshëm të bashkoheshin me Mikron, por nuk kishte hapësirë në ndërmarrje për të ndërmjetësuar më shumë nxënës;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 3 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit vlerësojnë punën praktike në biznese, sepse ajo ka më shumë larmi ushtrimesh dhe është më sfiduese;</li> <li>Nxënësit kishin vetëbesim gjatë praktikës, pasi ata kishin fituar aftësitë bazë në punëtorinë e shkollës;</li> <li>Monitorimi i nxënësve u realizua jo shumë shpesh nga mësimdhënësi përgjegjës për praktikën;</li> <li>Vlerësimi i nxënësve do të bëhet në fund të praktikës;</li> </ul>	<p>konsideroi këtë si shumë të dobishme;</p> <p><b>Fokus grupet me 3 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit u angazhuan 2 ditë (8 orë) në javë, me vullnetin e tyre ata punuan gjithashtu edhe të shtunën;</li> <li>Vetëm 3 nxënës janë paguar nga Mikron 100 euro në muaj, ndërsa Vegëltorja "Plus" nuk i ka paguar nxënësit.</li> <li>Ndërmarrja kishte dy instruktorë në ndërmarrje;</li> <li>Të gjithë nxënësit e përzgjodhën shkollën me vullnetin e tyre dhe nuk duan të vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm;</li> </ul>
9	<b>"Nexhmedin Nixha" Gjakovë</b>	9	13	4	6	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mentaliteti i biznesit është i ngjashëm me atë të Vushtrrisë; Shumica e tyre hezitojnë të</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>MVP-ja duhet të zbatohet sipas procedurave të Udhëzimit Administrativ;</li> </ul>

	<p><b>Nxënësit e klasës së 11-të</b></p> <p><b>3 Creativ</b> <b>5 First</b> <b>1 First 1</b> <b>2 Wear &amp; go</b> <b>2 Coton GJ</b></p> <p><b>Tekstil</b></p>					<p>kompensojnë nxënësit në çfarëdo forme;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mungesa e buxhetit për transportin e mësimdhënësve, si dhe kompensimit për transportin nga ana e bizneseve;</li> <li>Të gjithë nxënësit (përveç ndërmarrjeve të tekstilit) u ndërmjetësuan në ndërmarrje bazuar në orët e praktikës të shënuara në kurrikulë</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 16 nxënës;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjithë nxënësit që morën pjesë në diskutimin e grupit të fokusit ishin nga profili auto-mekanikë të ndërmjetësuar para fillimit të skemës MVP; nxënësit nga ndërmarrjet e tekstilit nuk mundën të marrin pjesë. Prandaj, konsiderojmë se të gjeturat nga diskutimi nuk duhet të përfshihen në të gjeturat, pasi ato nuk janë relevante për skemën MVP;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Më shumë seanca informuese dhe prezantime të Udhëzimit Administrativ për MVP-të duhet të mbahen/realizohen me mësimdhënësit për të shpjeguar rolin dhe përgjegjësinë e tyre në zbatimin e skemës së MVP-së;</li> <li>Edhe pse shumica e nxënësve u ndërmjetësuan në biznese pa asnjë kompensim, shkolla ngurron të ndërpresë bashkëpunimin pasi që ata konsiderojnë se nxënësve përfitojnë së paku disa aftësi.</li> <li>Nxënësit e angazhuar në Creativ e gjetën ndërmjetësimin me iniciativën e tyre;</li> </ul>
10	<p><b>“Feriz Gurri dhe vellezerit Caka” Kaçanik</b></p> <p><b>Nxënësit e klasës së 11-të</b></p> <p><b>8 Kivo</b></p>	10	8	1	1	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pozitat e MVP-së në "KIVO" nuk përputhen me profilet e ofruara në shkollë;</li> <li>Zbatimi i MVP-së në KIVO u vonua për shkak të vonesave nga KIVO, 8 nxënësit u ndërmjetësuan në fillim të prillit;</li> </ul>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qendra e Karrierës duhet të jetë më aktive në identifikimin e bizneseve të reja;</li> <li>OK do të duhet të kryejë rregullisht vlerësimin e tregut lokal të punës;</li> <li>Shkolla e AAP-së duhet të hapë profilet që korrespondojnë me</li> </ul>

	Instalim elektrik					<p><b>Pa grup fokusi me nxënësit pasi që ata filluan së voni</b></p>	<p>nevojat e tregut lokal të punës, p.sh. për operatorin e prodhimit "KIVO" dhe mekatronikën.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjithë nxënësit janë kompensuar me 50 euro në muaj, ushqim dhe sigurim të aksidenteve;</li> <li>• Nxënësit u angazhuan 2 ditë (8 orë) në javë;</li> </ul> <p><b>Pa grup fokusi me nxënësit pasi që ata filluan së voni;</b></p>
11	<p><b>"11 Marsi"</b> <b>Prizren</b> <b>Nxënësit e klasës së 11-të</b></p> <p><b>3 Nurçelik</b> <b>0 Albing</b></p> <p><b>Dizajner metali</b></p>	5	3	2	1	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fasilitimi u realizua nga zëvendës drejtori, ndërkohë që përzgjedhja e nxënësve ishte bërë nga mësimdhënësi përgjegjës për praktikën profesionale;</li> <li>• Nurçelik intervistoi të gjithë nxënësit para përzgjedhjes;</li> <li>• Shumica e nxënësve kanë biznese familjare, prandaj nxënësit e ndërmjetësuar janë ata që kanë mbetur pa ndonjë mundësi</li> <li>• Nxënësit nuk mundën të fillojnë në ndërmarrjen "Albing", pasi që kurrikula nuk përputhej me profilin e biznesit;</li> <li>• Shkolla është në gjendje më të mirë nga koha që menaxhohet nga AVETAE, veçanërisht në sigurimin më të lehtë të lëndës së parë;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 3 nxënës</b></p>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhmenti i shkollës ishte shumë i interesuar në zgjerimin e skemës së MVP-së, ndërsa mësimdhënësit hezitojnë duke u arsyetuar me punëtoritë e pajisura në shkollë.</li> <li>• Zëvendës drejtori dhe dy mësimdhënës morën pjesë në trajnimin e instruktorëve në ndërmarrje të organizuar nga GIZ. E konsiderojnë këtë si shumë të dobishme;</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 3 nxënës</b></p> <p>Të gjithë nxënësit janë kompensuar me 50 euro në muaj duke përfshirë edhe ushqimin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit u angazhuan 2 muaj e gjysmë (8 orë) në ditë me orar bllok</li> </ul>

						<ul style="list-style-type: none"> <li>Një nga nxënësit konsideron se puna ishte paksa e rëndë, ndërsa dy të tjerët rekomandonin që të kishin një periudhë më të gjatë të punës praktike dhe pagesa më të larta si stimulim;</li> <li>Nurçelik zgjodhi 6 nxënës për skemën e MVP-së, por tre prej tyre nuk ishin të interesuar të fillojnë për shkak të pagesës së ulët;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit rrallë punonin jashtë orarit por u kompensuan me 20 euro shtesë</li> <li>Monitorimi i nxënësve është realizuar një herë në 2 javë nga mësimitdhënësi përgjegjës për praktikën;</li> <li>Të tre nxënësve iu ofrua të punonin gjatë kohës së verës, por asnjëri prej tyre nuk është i interesuar të punojë për shkak të pagesës së ulët;</li> <li>Vetëm njërit nxënës i është ofruar për të vazhduar skemën MVP në klasën e 12-të;</li> <li>Ndërmarrja kishte instruktorë në ndërmarrje;</li> <li>Të gjithë nxënësit e kanë zgjedhur vetë shkollën;</li> <li>Nxënësit e vlerësojnë mentorimin dhe vlerësimin nga ndërmarrjet;</li> </ul>
12	<p><b>“Jonuz Zejnullahu” Viti Nxënësit e klasës së 12-të</b></p> <p><b>1 Autoprodukti</b>  <b>1 Automekanik</b>  <b>1 Auto BEKA</b>  <b>2 Emi Center</b>  <b>3 Vinex</b>  <b>1 Axxustatori</b></p>	23	9	8	6	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkesa për angazhimin e nxënësve nga ndërmarrjet ishte më e lartë, por profili i kërkuar prej tyre nuk mund të ofrohet nga shkolla.</li> <li>Fasilitimi me ndërmarrjet është i vështirë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në dispozicion (mungesa e Qendrës së Karrierës);</li> </ul> <p><b>Fokus grupet me 9 nxënës</b></p>	<p><b>Shkolla e AAP-së</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkollat duhet të fasilitojnë komunikimin me më shumë biznese nëpërmjet shoqatës lokale të biznesit;</li> <li>MVP-ja duhet të zbatohet sipas procedurave të Udhëzimit Administrativ;</li> <li>Më shumë seanca informuese dhe prezantime të Udhëzimit Administrativ për MVP-të duhet të mbahen/realizohen me</li> </ul>

						<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedhja dhe ndërmjetësimi i nxënësve është bërë nga mësuesi përgjegjës për praktikën profesionale; nxënësit nënkruan marrëveshje për ndërmjetësimin në ndërmarrje;</li> <li>• Të gjithë prindërit u njoftuan nga shkolla për mundësinë e praktikës;</li> <li>• Punëtoritë e shkollave janë të pajisura dobët;</li> </ul>	<p>mësuesit për të shpjeguar rolin dhe përgjegjësinë e tyre në zbatimin e skemës si MVP-së;</p> <p><b>Fokus grupet me 9 nxënës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjithë nxënësit u udhëzuan nga instruktorët në ndërmarrje;</li> <li>• Një nga nxënësit e ndërmjetësuar në Vinex planifikon të fillojë biznesin e tij në shtet;</li> <li>• Nxënësit vlerësojnë punën praktike në biznese, sepse ajo ka më shumë larmi ushtrimesh dhe është më sfiduese;</li> <li>• Vetëm 2 nxënës nga Emi Center nuk u kompensuan; të tjerët u kompensuan me nga 50-100 euro në muaj. Përveç kësaj, të gjithë nxënësit pranuan ushqim dhe shumica e tyre kompensim për transport.</li> <li>• Nxënësit e ndërmjetësuar në punëtoritë automekanike kalojnë më shumë se 2 ditë në biznes, ndërsa saldatorët kalojnë vetëm 2 ditë;</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	---	---